



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), më datë **23.09.2014**, realizoi **vizitë të rregullt** në Institucionin Publik Azili i Pleqve “Kiro Kërsteski – Platnik” në Prilep. Kjo vizitë u realizua në bashkëpunim me Shoqatën e Punonjësve Social të Qytetit të Shkupit dhe Shoqatën e Infermiereve, Mamive dhe Teknikëve të RM-së. Duke e pasur parasysh se ky institucion është i llojit të hapur dhe në të shfrytëzuesit vendosen mbi bazë vullnetare, kështu që fokusi u vu mbi kushtet materiale në të cilat janë vendosur, kujdesin përkatës shëndetësor dhe mbrojtjen sociale, si parakushte të cilat nevojiten për trajtim human dhe dinjitoz me personat e moshuar. Gjatë vizitës, ekipi i MPN-së udhëhiqej nga Kodeksi i Etikës për trajtimin e personave të moshuar, sipas të cilit kërkohet që me të njëjtët të veprohet si me personalitete dhe të respektohen të drejtat e njeriut, të mos ushtrohet diskriminim, të kenë qasje në ushqim të shëndetshëm, ujë të pastër, vendosje, veshmbathje dhe mbrojtje shëndetësore. Në kuadër të këtij Kodeksi potencohet edhe shfrytëzimi i llojeve përkatëse të kujdesit institucional dhe jashtë-institucional. Po ashtu, personat e moshuar duhet të mbrohen nga çdo lloj i formave të dhunës fizike ose psikike, ta dinë të vërtetën nëse janë në gjendje të gjykojnë në mënyrë të pavarur dhe t’i manifestojnë ndjenjat sipas mënyrës së tyre.

Mekanizmit Parandalues Nacional nuk iu paraqitën ankesa për torturë ose lloje tjera të trajtimit brutal, johuman ose nënçmues. Megjithatë, një pjesë e shfrytëzuesve, sidomos personat e palëvizshëm, u ankuan se sjellja ndaj tyre është jokorrekte, se zbatohet larje grupore, por edhe se mirëmbajtja e higjienës në këto ambiente nuk është në nivelin e duhur. Gjithashtu, si problem u imponua ngrohja e pamjaftueshme e ambienteve, si dhe mosmirëmbajtja e dhomave në pjesën përdhese. Edhe pse shfrytëzuesit, të cilët janë të vendosur në pjesën përdhese paguajnë shumë më të vogël, megjithatë nuk guxojnë të diskriminohen për shkak të statusit të tyre social dhe të vendosen në kushte të cilat e rrezikojnë dinjitetin e tyre njerëzor. Ambientet e njëjta duhet të bojatisen, të mirëmbahen me rregull dhe të kenë shtroje adekuate dhe batanije për t’u mbuluar.

Higjiena e pamjaftueshme, si dhe kujdesi ndaj shfrytëzuesve kushtëzohet edhe me numrin e vogël të personelit, të cilin e ka në dispozicionin ky Azil edhe atë veçanërisht me dado, të cilat/cilët sipas standardeve duhet të jenë gjithsej 20, si dhe të ketë të punësuar dado meshkuj, të cilët do të kujdeseshin për shfrytëzuesit meshkuj. Edhe pse azili ka mjek koncesioner, i cili është mjek amë i shfrytëzuesve, megjithatë nevojitet që drejtoria e institucionit të kërkojë nga i njëjti ta përforcojë mbikëqyrjen dhe kujdesin mjekësor mbi personat e palëvizshëm, si dhe të zbatojë përkujdesje shtëpiake në vet institucionin, duke i marrë parasysh vitet dhe kufizimet e personave të vendosur në këtë institucion.

Në institucion, përveç personave të moshuar përkujdesen edhe grupe të tjera sociale vulnerable (viktima të dhunës në familje, të pastrehët, fëmijët në rrugë etj.) me karakter të përkohshëm, me kërkesë të MPB-së dhe qendrës për punë sociale, si rezultat i mospasjes së formave tjera jashtë-institucionale të mbrojtjes së grupeve të cekura vulnerable.